




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, neni 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 40 paragrafi 2 pika h), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 35 paragrafi 1 dhe 2 shkronja h), të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të kuvendit të mbajtur me datën 01.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

(Për shpalljen “Qytetar Nderi” të Komunës së Skenderajt z.Vaughan Smith)

Neni 1

Miratohet propozimi-vendimi më Nr.02-170/01-0010227/25, të datës 17.03.2025, Për shpalljen “Qytetar Nderi” të Komunës së Skenderajt z.Vaughan Smith.

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi”, të Komunës së Skenderajt, i ndahet video-gazetarit Britanik, z.Vaughan Smith, në shenjë respekti dhe mirënjohje për kontributin e dhënë në pasqyrimin e realitetit dhe sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar për luftën e popullit shqiptar të Kosovës për liri dhe pavarësi, si: pasqyrimin e Epopesë së UÇK-së në Prekaz, më 5,6 dhe 7 Mars 1998, Masakrës së Abrisë, filmimin e intervistës me heroin Fehmi Ldrovci, incizimin e Parashutistëve Britanikë gjatë ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, si dhe realizimin e filmit të njohur për Luftën e Kosovës, i titulluar “The Valley”, i cili mbetet një ndër dokumentarët më të vlerësuar.

Neni 3

Titulli “Qytetar Nderi” të Komunës së Skenderajt z.Vaughan Smith, do ti ndahet në seancën solemne, që do të mbahet më 18 Qershor 2025, në Ditën e Çlirimit të Skenderajt.

Neni 4

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë; Kryetari të Komunës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi, me nënshkrimin nga Kryesuesja e Kuvendit dhe publikimin në web-faqe zyrtarë të Komunës së Skenderajt.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit,
- 1x1 z.Vaughan Smith “Qytetar Nderit”,
- 1x1 Dosjes.

